

DEKLARATE E THEMELIMIT TE PARTISE

Duke u nisur nga :

- Vullneti i forcave progresiste që sollën ndryshimin rrënjësor të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni për të vazhduar angazhimin e tyre në procesin e demokratizimit të mirëfilltë të Maqedonisë;
- Përkrahja masovike që këto forca gëzojnë në popullatë dhe dëshira e shprehur e qytetarëve për inkuadrimin e tyre në jetën politike si garancë për realizim të barazisë së plotë të të gjithë qytetarëve në Maqedoni si kusht i domosdoshëm për paqë dhe stabilitet;
- Situata e rënduar politike, ekonomike dhe sociale në vend që kërkon qasje dhe ide të reja për t'u tejkaluar sa me shpejt,
Lindi nevoja për themelimin e një partie të re që u emërtua „Bashkimi Demokratik për Integrim“, parti kjo e cila angazhohet për:
- Implementimin e plotë të Marrëveshtjes së Ohrit;
- Maqedoni stabile, si interes parësor i të gjithë qytetarëve dhe si interes rajonal dhe europian;
- Maqedoni multietnike, ku të gjithë qytetarët e saj do të ndjehen të lirë dhe të barabartë;
- Çrrënosjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe vendosjen e mekanizmave që do të pamundësojnë përhapjen e tyre;
- Integrimin e Maqedonisë në strukturat euro-atlantike, duke u nisur nga integrimi rajonal sipas modeleve më të avancuara europiane dhe botërore;
- Sistem ekonomik bashkëkohor, i cili do të krijojë hapësirë dhe garancë për investime të huaja, rrjedhimisht do të zvogelojë papunësinë;
- Demokraci funksionale dhe shtet ligjor, me theks të veçantë në respektimin e të drejtave të njeriut.
Përparësi për veprim imediat të partisë janë:
- Integrimi dhe risocializimi i ish-luftëtarëve në shoqëri;
- Kthimi i të gjithë refugjatëve në vendbanimet e tyre;
- Rindërtimi i vendbanimeve të dëmtuara vitin e kaluar;
- Kthimi dhe ngritja e mirbësimit ndër-etnik;

- Masa urgjente për zbutjen e varfërisë.
BDI do të veprojë në drejtim të:
 - Decentralizimit të pushtetit dhe zhvillimit të demokracisë vendore
 - Arritjen e barazisë së plotë në të gjitha nivelet e shoqërisë;
 - Avancimin e pozitës së femrës në nivelet e vendim-marrjes;
- Zgjidhjen e problemit të arsimit të sipëror në gjuhën shqipe me kujdes të veçantë në rritjen e kualitetit dhe profesionalizmit;
- Inkuadrimit të emigracionit në rrjedhat shoqërore në Maqedoni me theks të veçantë në kthimin e tyre në vendlindje dhe investim të kapitalit.
Bashkimi Demokratik për Integrim fton:
 - Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të angazhohen në ndërtimin e shoqërisë multietnike,
 - Subjektet politike në Maqedoni të respektojnë obligimet e marra në Ohër për arritjen e stabilitetit politik;
 - Komunitetin ndërkombëtar që të vazhdojë me përkrahjen e implementimit të Marrëveshjes së Ohrit dhe të demokratizimit të Maqedonisë për t' i mundësuar asaj që të arrijë standardet ndërkombëtare të duhura për integrim në familjen e shteteve demokratike.

Tetovë, 5 Qershor 2002

Kuvendi Themelues i Bashkimit Demokratik për Integrim-BDI